
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Tiranë, më 08.04.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje/pjesësh për vënien në gatishmëri teknike të radarit në PRT-14 Llogara”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Pjesë të pajisjeve radio dhe radar 32352100-6, Pjesë këmbimi dhe pajisje radar 32352200-7

VLERA E FONDIT LIMIT TË KONTRATËS:

Fondi limit: **20,903,581 (njëzet milion e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa tvsh** ose 218,018.16 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëmbëdhjetë pikë gjashtëmbëdhjetë) EURO pa tvsh.

*Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 08.04.2026, me kurs këmbimi 95.88(nëntëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e tetë) lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, ndërsa nga ana e grupit të punës të ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Komanda e Forcave Detare janë hartuar specifikimet teknike me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbeshtetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit objekt prokurimi**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është e mbështetur në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues,

duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Në nenin 42 pika 3 përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. **Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit**” dhe nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është mbi vlerën e kufirit të lartë monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës. **Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë.** Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore.

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën

vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilnaceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me:

- a) **Standardin ISO 9001** ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuar nga një

organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në piken I të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë “të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.*

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për artikujt objekt prokurimi. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: *Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.*

Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfutuesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për

besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkimi i autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për këtë pajisje është një masë e mirë për të mbrojtur interesat e institucionit j dhe për të siguruar një prokurim të drejtë dhe transparent.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike/broshurë për artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike/broshurë nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qendror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.*

Kërkesa për katalogun /skedën teknike/broshurën ka disa avantazhe pasi siguron besueshmëri të informacionit. Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Në këto forme reduktohet rreziku i mashtrimeve ose i ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër, përmes përmbushjes së kësaj kërkesë, AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.5 Për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, për të realizuar instalimet, konfigurimet dhe tarimin e pajisjeve objekt prokurimi operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik si më poshtë vijon:

- a. Të paktën 1 (një) inxhinier Elektronik/ Telekomunikacioni
- b. Të paktën 1 (një) specialist montimi të çertifikuar për punime në lartësi.

Operatori ekonomik në lidhje me stafin teknik të kërkuar më sipër duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

Në lidhje me stafin inxhinierik:

- Kontratë pune të vlefshme;
- Diplomë universitare (Bachelor ose Master).
- Listpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Për stafin teknik të çertifikuar:

- Kontratë pune të vlefshme ose kontratë bashkëpunimi
- Çertifikatë/Diplomë/Dëshmi kualifikimi lëshuar nga kompania prodhuese e pajisjeve /distributorë të autorizuar nga prodhuesi ose çertifikime ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/çertifikuara për dhënien e tyre, me qëllim kryerjen e instalimit konfigurimit të pajisjeve, të cilat janë objekt prokurimi.

Shenim: Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.5 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteret e kualifikimit janë vendosur për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, duke marrë në konsideratë kompleksitetin teknik të artikujve të përfshirë në preventiv, afatin e realizimit prej 90 ditësh, si dhe nevojën për siguri teknike dhe funksionale gjatë procesit të instalimit, konfigurimit dhe tarimit të pajisjeve.

Operatori ekonomik të disponojë të paktën 1(një) inxhinier Elektronik/ Telekomunikacioni, është vendosur për të garantuar kapacitetin minimal dhe të nevojshëm profesional për realizimin korrekt të kontratës.

Punonjësi(i) i diplomuar siguron:

- koordinimin dhe mbikëqyrjen teknike të procesit të instalimit dhe konfigurimit.
- zgjidhjen e problematikave teknike gjatë vënies në funksionim.
- respektimin e standardeve teknike dhe funksionale.

Prania e këtij kapaciteti profesional përfaqëson garancinë minimale që operatori ekonomik është teknikisht i aftë për të menaxhuar dhe realizuar kontratën.

Inxhinieri i mesiperm do te kryeje konfigurimin e sinjaleve ACP (Azimuth Count Pulse) dhe ARP (Azimuth Reference Pulse-ARP), caktimin e zonave të ndaluara (Blanking Zones) dhe sinkronizimin me bllokun e radarit. Gjithashtu do të kryerjë tarimin (rregullimin e azimitit dhe distancës), suprimimin e zhurmave (Clutter rejection) dhe hartimin e Raportit Teknik final. Pajisjet e radarit

(antenë X-band, magnetron, karta analoge, encoder, dehidrator) janë sisteme komplekse elektronike dhe telekomunikacioni. Për instalimin, konfigurimin dhe tarimin e tyre kërkohet njohuri mbi sinjalet RF, përpunimin analog/digital, kalibrimin e azimutit dhe integrimin e sinjaleve ACP/ARP. Pa qënësini e një inxhinieri elektronik/telekomunikacioni, nuk mund të sigurohet funksionimi i saktë i sistemit radar, i cili është kritik për gatishmërinë teknike.

Në vijim në preventiv janë të përfshirë edhe zëra shërbimi të cilat konsistojnë si më poshtë vijon:

- Punimet e instalimit të pjesëve përbërëse të antenës do të kryhen në Majën e Thanasit, Llogara (Vlorë), në një kullë vertikale 20 m lartësi.
- Në punimet që do të kryhen përfshihen montimi mekanik, tokëzimi, konfigurimi i shpejtësisë së rrotullimit dhe sinjaleve ACP/ARP, si dhe tarimi (kalibrim azimuti, distancë, suprimim zhurmash).
- Gjithashtu përfshihet edhe testimi në vend dhe dorëzimi i raportit teknik. “Testimi në vend i antenës dhe dorëzimi i raportit teknik për punimet e kryera.”

Nisur nga sa më sipër është e nevojshme që ofertuesi i mundshëm ekonomik të ketë të punësuar ose të kontraktuar për realizimin e këtij objekti 1 (një) person të certifikuar për punime në lartësi pasi punimet e instalimit të pjesëve përbërëse të antenës do të kryhen në një kullë vertikale 20 metra, me shkallë të jashtme dhe profile metalike. Punimet për montim, nivelim, tokëzim dhe vendosje kërkojnë punë në lartësi të konsiderueshme. Në këtë rast rreziku i aksidenteve është i lartë pa personel të trajnuar dhe të çertifikuar për punime në lartësi. Një specialist i tillë garanton respektimin e standardeve të sigurisë dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për përmbushjen e afatit të garancisë për pajisjet objekt prokurimi konform përcaktimit të bërë në specifikimet teknike duke nisur nga data e instalimit dhe vendosjes në funksion të plotë të tyre dhe gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve që vijnë për shkak të prodhimit dhe instalimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se artikujt e ofruar janë cilësorë dhe sipas standardeve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të defekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit apo instalimit të tyre.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të mallit në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.



Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.



II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike është grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfutues Komanda e Forcave Detare për objektin që prokurohet, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar. Specifikimet teknike janë si më poshtë vijon;

SPECIFIKIMET TEKNIKE JANË SI MË POSHTË VIJON:

Nr.	Emërtimi materialit	Specifikimet Teknike, Përmasat, Fuqia (Kodi nëse ka) dhe Destinacioni i përdorimit	Foto e Artikullit
PAJISJE/PJESË PËR VENDOSJEN NË GATISHMËRI TEKNIKE TË RADARIT NË PRT-14 LLOGARA			
1	Sistem Antene X-band ASX-1901C (bashkë me aksesoret përkatës)	Modeli: AU12-19C Part no: AE055608, MU-1022X, EM012522 Banda: X Frekuenca: 8.9 – 9.4 GHz Tipi: Slotted Waveguide Array Polarizimi: Circular Gjatësia: rreth 5.9 metra (19ft) Shpejtësia e rrotullimit: 12-22 rpm Rezistenca ndaj erës : deri në 100 knots	

		<p>Temperatura operative: - 25°C deri +55°C</p> <p>Instalohet në kullën e radarit. Është komponenti që realizon transmetimin dhe marrjen e sinjalit radar në bandën X.</p>	
2	Encoder	<p>Model : Kubler</p> <p>Part no: EM020560</p> <p>Tipi: 8.5000.0311.4096.s028</p> <p>Rezolucioni: 4096 pulse për rrotullim</p> <p>Rezolucioni angular: 0.088°</p> <p>Tipi i sinjalit: RS422</p> <p>Tension furnizimi: 5-30 VDC 90mA</p> <p>Shpejtësia maksimale: deri 12,000 rpm</p> <p>Mbrojtja: IP65-IP67</p> <p>Sensor pozicioni dhe rrotullimi që përdoret të përcaktuar azimuth-in e antenës gjatë rrotullimit.</p>	
3	Magnetron	<p>Model : MG5222</p> <p>Part no: EV050452</p> <p>Tipi: Magnetron me pulsime</p> <p>Fuqia: 25Kw</p> <p>Frekuenca: X-Band, 9345-9405 Ghz</p> <p>Instalohet në bllokun e radarit.</p> <p>Pesha: rreth 1.5</p> <p>Tensioni i anodës: 7.5 – 8.5 Kw</p> <p>Dalja RF: Me valëkalues UG-40B</p>	

		Përdoret si burimi kryesor i energjisë mikrovalore në radarët detarë X-Band.	
4	Kartë Analogue Board	<p>Model : ITS-26000 Part no: EB085200 Tipi: Radar Analog Processing Board Funksioni: Procesim video&amplifikim Fuqia e amplifikimit: 40-80Db Video Bandwith: deri 20MHz Input signal: radar IF Output: analog radar video Furnizimi: ±12V / + 5V DC Është kartë elektronike analoge e përpunimit të sinjalit radar nga RF në video radar.</p>	
5	Dehidrator	<p>Model : Andrew MR050-81046 Part no: AE990021-R1 High-pressure Desiccant Dehydrator, 19 in rack mountable, 3.0-5.0 psig, 240 V AC, 50/60 Hz Airflow 300l/h Dew point ≤ -45°C Redukton lagështinë në waveguides dhe modulët RF për të parandaluar kondesimin dhe degradimin e performancës së radarit.</p>	

6	Instalimi, konfigurimi dhe tarimi i antenës së radarit	<p>Vendi: Maja e Thanasit Llogara (Vlorë).</p> <p>Gjatësia e kullës: 20 metra.</p> <p>Tipi i kullës: Kullë vertikale, vetë-mbështetëse me tre këmbë me bazë katrore (ku vendoset antena e radarit) me shkallë të jashtme e përbërë nga tuba të fortë dhe profile këndore.</p> <p>Punimet që do kryhen:</p> <p>Instalimi: Montimi i pjesëve përbërëse të antenës. Montimi mekanik i saj në pedestal, sigurimi i nivelimit horizontal. Tokëzimi i antenës.</p> <p>Konfigurimi: Konfigurimi i shpejtësisë së rrotullimit. Caktimi i zonave të ndaluara. Kofigurimi i sinjaleve ACP/ARP me bllokun e radarit.</p> <p>Tarimi: Rregullimi i azimutit, kalibrimi i distancës, suprimimi i zhurmave. Testimi në vend i antenës dhe dorëzimi i raportit teknik për punimet e kryera.</p>
---	--	--

Në zbatim të procedurës për prokurim me objekt “Blerje pajisje/pjesë për vënien në gadishmëri teknike të radarit në PRT-14 Llogara”, grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Komanda e Forcave Detare ka analizuar nevojat teknike për vendosjen në gatishmëri operacionale të radarit në PRT-14 Llogara dhe ka hartuar specifikimet teknike për pjesët përkatëse.

Qëllimi i këtij prokurimi është sigurimi i pjesëve rezervë dhe komponentëve teknikë të domosdoshëm për rikthimin dhe ruajtjen e funksionalitetit operacional të radarit të PRT-14 model Seafalcon, i cili përdoret për vëzhgimin dhe monitorimin e hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë.

Për shkak të natyrës së specializuar të sistemit të radarit, komponentët e kërkuar duhet të jenë plotësisht të përputhshëm me konfigurimin ekzistues teknik të sistemit dhe me arkitekturën elektronike të tij.

Radari i PRT-14 është një sistem i integruar elektronik që përbëhet nga një sërë komponentësh specifikë hardëare dhe module elektronike të projektuara për të funksionuar në mënyrë të integruar sipas standardeve dhe parametrave të prodhuesit.

Nga analiza teknike e dokumentacionit të radarit rezulton se pajisje/pjesët e kërkuara në specifikimet tekniket nga numri rendor 1 (një) deri në numrin rendor 5(pesë), janë pjesë origjinale të prodhuesit, të projektuara dhe prodhuara ekskluzivisht nga kompania GEM elettronica, e cila është prodhuesi dhe furnizuesi i teknologjisë së radarit që disponon Forca Detare dhe i komponentëve të tij.

Për shkak të arkitekturës së mbyllur teknologjike të sistemit të radarit, këto pjesë:

- janë të projektuara specifikisht për këtë sistem radari,
- kanë ndërfaqe elektronike dhe softërike të dedikuara,
- integrim të drejtpërdrejtë me sistemin ekzistues hardëare dhe softëare,
- **nuk prodhohen nga prodhues të tjerë dhe nuk kanë alternativa ekuivalente në treg.**

Përdorimi i komponentëve të tjerë jo origjinalë do të sillte:

- mosfunksionim të sistemit,
- probleme kompatibiliteti elektronik dhe softëerik,
- ulje të sigurisë dhe besueshmërisë së radarit,
- humbje të garancisë teknike dhe mbështetjes nga prodhuesi.

Përshkrimi i pjesëve në specifikimet teknike nga numri 1 (një) deri në numrin rendor 5(pesë) dhe arsyet pse i grupi i punës i është referuar prodhuesit GEM elettronica janë të shpjeguara teknikisht si më poshtë;

1.Antena X-Band ASX-1901C

Funksioni: Transmetimi dhe marrja e sinjalit radar në bandën X, për zbulimin dhe gjurmimin e objekteve në det.

Arsye për furnizim nga prodhuesi origjinal: Përshtatje e plotë me transmetuesin, marrësin dhe algoritmet e radarit SeaFalcon.

2.Encoder Kübler 4096

Funksioni: Mat pozicionin angular të antenës për sinkronizimin e transmetimit dhe marrjes së impulseve të radarit.

Arsye për furnizim nga prodhuesi origjinal: Integrim i plotë me mekanizmin e rrotullimit dhe sistemin e përpunimit të sinjalit.

3.Magnetron MG5222

Funksioni: Gjeneron impulse mikrovale me fuqi të lartë për transmetim në antenë.

Arsye për furnizim nga prodhuesi origjinal: Dizajn specifik për transmetuesin e radarit SeaFalcon.

4.Analog Board ITS-26000

Funksioni: Përpunim analog i sinjalit radar, amplifikim, filtrim, STC/AGC dhe konvertim në video radar.

Arsye për furnizim nga prodhuesi origjinal: Integrim i plotë me receiver dhe procesor digjital; zëvendësimi do të degradonte performancën.

5.Dehidrator Andreë MR050-81046

Funksioni: Redukton lagështinë në ëaveguides (valëkalues) dhe modulët RF për të parandaluar kondensimin dhe degradimin e performances së radarit.

Arsye për furnizim nga prodhuesi origjinal: Siguron performancë të qëndrueshme në mjedisin detar.

Në përputhje me nenin 36, pika 3 dhe 4 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në hartimin e specifikimeve teknike nuk duhet të përmendet një markë apo burim specifik që favorizon një operator ekonomik, përveç rasteve përjashtimore kur objekti i kontratës nuk mund të përshkruhet në mënyrë të mjaftueshme dhe të kuptueshme.

Në rastin konkret, për shkak të karakteristikave teknike të sistemit të radarit dhe natyrës së komponentëve të tij, përshkrimi i pjesëve në specifikimet teknike nuk mund të realizohet në mënyrë të plotë vetëm nëpërmjet parametrave teknikë të përgjithshëm, pasi ato janë pjesë specifike të projektimit të prodhuesit.

Për këtë arsye, referimi ndaj prodhuesit GEM elettronica bëhet vetëm për qëllim identifikimi teknik të komponentëve të kërkuar dhe për të garantuar përputhshmërinë e plotë me sistemin ekzistues.

Gjithashtu, në përputhje me nenin 36, pika 3 dhe 4 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, referimet ndaj markave apo prodhuesve lejohen vetëm në raste të justifikuara teknikisht dhe duhet të shoqërohen me shprehjen “ose ekuivalente”, për aq sa është e aplikueshme.

Duke marrë në konsideratë:

- natyrën teknologjike të sistemit radarit,
- faktin që komponentët janë pjesë origjinale të projektimit të prodhuesit,
- nevojën për garantimin e kompatibilitetit teknik dhe funksionimit të sigurt të sistemit,

Grupi i punës kja konkluduar se përfshirja në specifikimet teknike e referencës ndaj prodhuesit GEM elettronica është e domosdoshme dhe e justifikuar teknikisht, në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 dhe nenin 78 të VKM nr. 285/2021.

Afati i garancisë për materialet të kërkuara do të jetë 1 (një) vit duke filluar nga koha e instalimit të tyre.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit, bazuar në nevojat e autoritetit kontraktor përfitues. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- *Dokumentat e tenderit*
- *Specifikimet teknike*

NJËSIA E PROKURIMIT

